



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM  
Nr.93, Datë 28.04.2022

**MBI  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ECO - ELB” SH.A. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI I PËRPUNIMIT TË  
MBETJEVE URBANE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2850 KW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma” a”, të ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 37, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ECO - ELB” sh.a., në datën 12.04.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali TEC (përpunimi i mbetjeve urbane), me kapacitet të instaluar 2850 kW. Në vijim të korrespondencës së zhvilluar mes ERE-s dhe shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., në datat 20.04.2022, 22.04.2022 dhe 28.04.2022, është depozituar nga ana e shoqërisë dokumentacioni përkatës.
- Shoqëria “ECO - ELB” sh.a. ka shpjeguar se me mbarimin e licencës së shoqërisë “Albtek Energji” sh.p.k, për shkak të vendosjes nën sekuestro konservative të të gjithë aseteve të saj, nuk mundi të realizohej në kohë transferimi i centralit (sipas parashikimit të nenit 26, të kontratës së koncesionit të formës BOT), tek shoqëria “ECO - ELB” sh.a., shoqëri kjo e fundit e krijuar për zbatimin e detyrimit koncesionar të transferimit të impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane.
- Më tej shoqëria bën me dije se nga data 17.12.2021 deri në datën 28.03.2022, midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), bashkive të qarkut dhe shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., janë zhvilluar takime dhe negocime të vazhdueshme për të bërë të mundur marrjen në përdorim të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike. Po ashtu vijon duke informuar se në datën 28.03.2022, u arrit nënshkrimi i kontratës së qirasë me nr. 548 (dërguar edhe në ERE), midis Agjencisë së

Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara dhe shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., dhe nga kjo datë ky impiant administrohet nga shoqëria me kapital publik “ECO - ELB” sh.a.

- Sipas shoqërisë gjatë periudhës dhjetor 2021 - mars 2022, situata e mbetjeve ishte dhe vijon të mbetet emergjente dhe nga data 15.12.2021 drejtori teknik i impiantit për shkak të mungesës së lëndëve të para të nevojshme për punën e impiantit ka urdhëruar fikjen e komanduar të tij. Që nga kjo datë mbetjet vetëm trajtohen në Landfilld (nuk digjen) dhe si i tillë nuk realizohet prodhimi i energjisë elektrike.
- Në këto kushte shoqëria “ECO - ELB” sh.a. bën me dije se e ka të domosdoshëm fillimin e menjëhershëm dhe pa vonesë të punës me kapacitet të plotë të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike. Ndodhur në kushtet e një situatë emergjente, kjo shoqëri kërkon nga ERE pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike me procedurë të përshpejtuar.
- Nëpërmjet Kontratës së qirasë nr. 548, datë 21.02.2022, të nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (Qiradhënësi) dhe shoqërisë “ECO – ELB” sh.a. (Qiramarrësi), i është dhënë zgjidhje tranzitore situatës emergjente të krijuar, për të parandaluar ndotjen ambientale dhe mjedisore nga depozitimi (mosdjegia) i mbetjeve urbane në landfilld. Kjo zgjidhje është dhënë ndër të tjera në bazë të korrespondencave shkresore midis Bashkisë Elbasan, Administratorit të komanduar të “Albtek Energy” sh.p.k., AAPSK “ECO – ELB” sh.a., dhe MIE-s (sikurse citohen respektivisht në kontratën e qirasë).
- *“Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, në nenin 37, “Përshpejtimi i afateve dhe ndryshimi i kërkesave procedurale”, parashikon se:  
Për kërkesat e paraqitura ne ERE për përshpejtim të një procesi objekt i vendimmarrjes se Bordit, për aq sa lejohet nga ligji, aty ku ka një shkak të arsyeshëm, Bordi do të lejojë personelin teknik të trajtoje një çështje me procedure të përshpejtuar apo me një procedure të ndryshme nga kërkesat procedurale të përcaktuar në rregullat e veçanta, kur i sheh ato të papraktikueshme, të papërshtatshme ose të panevojshme, me kusht qe ky proces të mos kufizojë të drejtat e palës, subjekt i procedurës të trajtuar nga Bordi.*
- Në zbatim të sa më sipër, vlerësohet në kushtet e emergjencës së bërë me dije nëpërmjet shkresës/kërkesës së shoqërisë “ECO – ELB” sh.a., ekziston shkaku i arsyeshëm për të trajtuar këtë kërkesë me procedurë të përshpejtuar, pasi situata emergjente e krijuar po cenon mjedisin, si rezultat i mosdjegies së mbetjeve urbane në zonën e Elbasanit dhe me gjerë. Gjithashtu, rregullimi tranzitor i bërë me kontratën e qirasë nr. 548, datë 21.02.2022, duke i kaluar në gëzim të përkohshëm shoqërisë “ECO – ELB” sh.a., të gjithë elementët strukturorë, ekonomikë, asete, dokumente ligjorë të ushtrimit të këtij aktiviteti, kundrejt pagesës mujore sipas përcaktimeve të saj, do të jetë referim edhe për afatin e vlefshmërisë së licencës që ERE do të lëshojë për këtë central (deri në datën 27.03.2023).

- Shoqëria ECO-ELB sh.a., me shkresën e datës 28.04.2022, ka depozituar në ERE shkresat e datës 31.03.2022, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për transferimin e lejeve përkatëse. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë të depozitujë në ERE dokumentet/qëndrimin përkatës të AKM-së në lidhje me transferimin e këtyre lejeve brenda datës 01.07.2022.
- Gjithashtu shoqëria ka depozituar në ERE në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin, përkatësisht kontratën e qirasë, statutin dhe aktin e themelimit të saj, të cilin shoqëria e ka depozituar në vijim sipas formatit të kërkuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “ECO - ELB” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali prodhues i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW, deri në datën 27.03.2023.
2. Brënda datës 01.07.2022 shoqëria “ECO - ELB” sh.a., të depozitujë në ERE dokumentet/qëndrimin përkatës të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në lidhje me transferimin e lejeve.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga bordi i ERE-s sipas përcaktimeve të nenit 16, dhe sipas nenit 40, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, ku përcaktohet se *“gjatë marrjes së vendimit, ERE duhet të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë vërejtjet ose kundërshtimet e arsyeshme e të bazuara, të paraqitura nga institucionet publike apo palët e tjera të interesuara, në lidhje me kërkesën për licencë, duke arsyetuar në vendim pranimin ose jo të tyre”*, si dhe në rast plotësimi/mosplotësimi të kushtit të pikës 2, të këtij vendimi
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**